

**PROF. MUHARREM FRASHËRI**

(1922 - )

**PRIFTI D., TROJA R.**

Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Departamenti i Kimisë Industriale

Profesor Muharrem Frashëri ka lindur në 10 Shtator 1922 në Hekal të Mallakastrës. Shkollën fillore e kreu në Frashër të Përmetit nga ku është edhe origjina e familjes së tij dhe në fshatin e lindjes. Më pas, në vitet 1934-1943 u arsimua në Liceun e Korcës, një nga Shkollat më të njohura jo vetëm në Shqipëri, por edhe jashtë saj. Në vitet e Luftës edhe pse në moshë fare të re Prof. Frashëri mori pjesë aktive në lëvizjen kundër pushtuesit. Pas çlirimit të vendit, kreu studimet e larta në Çekosllovakia, në Shkollën e Lartë të Inxhinjerisë Kimiko-Teknologjike të Pragës, ku u diplomua si Inxhinier i Kimisë dhe Teknologjisë së Ushqimeve.



Në vitet e Universitetit u shqua për pasionin, këmbënguljen dhe korrektesën që vazhdon ta shoqërojë gjatë gjithë jetës së tij. Në fillimet e karrierës profesionale ai ka kryer me sukses dhe devocion detyra të rëndësishme në institucione shtetërore, arsimore e shkencore. Ndër të tjera përmenden detyrat e vështira si Shef i Komitetit Ekzekutiv të Këshillit të Qarkut të Gjirokastrës, Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë, Kryeinspektor i Cilësisë në Ministrinë e Industrisë, Punonjës Shkencor i Labororit Kimik të Institutit të Shkencave etj. Mendimi i pjekur, menëuria, mirësia dhe komunikimi i ngrohtë me njerëzit ishin karakteristikat e tij, që e shoqëronin kudo, i lehtësonin zgjidhjen e detyrave të vështira për kohën dhe e rrisnin në profesion.

Megjithëse i zënë, i përkushtuar ndaj punës dhe familjes, profesor Frashëri, u shkëput për 4 vjet për të kryer Studimet Pasuniversitare në Institutin e Biokimisë në Akademinë e Shkencave të ish Bashkimit Sovjetik; në përfundim, në vitin 1960, u laureua me gradën shkencore Kandidat i Shkencave Biologjike. Që nga kjo periudhë Profesori ju përkushtua mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në Universitet, në Fakultetin e Shkencave Natyrore, ku ka kryer një veprimtari shumë të gjërë mësimore e kërkimore-shkencore, për një periudhë 30 vjecare, si punonjës efektiv. Ai ka qënë i ngarkuar me detyra mjaft të rëndësishme dhe i vendosur në poste drejtuese të Universitetit dhe Fakultetit, ku vazhdon të kontribuojë edhe sot me të njëjtin pasion e përkushtim. Në vitin 1964 mori titullin Docent dhe në vitin 1972 titullin Profesor.

Prej 30 vjetësh Profesori ka drejtuar Katedren e Teknologjisë Kimike, duke mbartur në të njëjtën kohë edhe funksione të tjera si Zv. Dekan i Fakultetit të Shkencave Natyrore, Kryetar i Degës Shkencore të Universitetit, Zv. Rektor i Universitetit të Tiranës, Kryeredaktor i Buletinit të Shkencave të Natyrës, Anëtar i Këshillave Shkencore të Institucioneve të ndryshme, Ministri, Institute etj.

Autorësinë e profesor Frashërit e mbajnë shumë programe e plane mësimore të nivelit Universitar e Pasuniversitar, disiplina të reja shkencore të Kimisë së Aplikuar, si Kimia dhe Teknologjia Ushqimeve, Mikrobiologjia Industriale e Ushqimore, Enzimologjia etj, shumë veprimtari kërkimore e shkencore, në tematika të Kimisë e Teknologjisë së Ushqimeve, Mikrobiologjisë e Bioteknologjisë. Ai është autori i 11 teksteve për Universitetin dhe shkollat e mesme, i mbi 30 artikujve të botuar në buletinet shkencore brenda dhe jashtë vendit, i shumë botimeve në periodikë dhe udhëheqës i mbi 50 punimeve të diplomave dhe 10 doktoratave. Emrin e tij mbajnë shumë ndryshime në strukturat akademike, për të rritur efektivitetin e punës në njësitë bazë të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor dhe për t'u përshtatur me institucionet e ngjashme me zë dhe eksperiencë në vendet e zhvilluara evropiane. Të rejtat e shkencës, të përvetësuar nga kualifikimet dhe specializimet jashtë vendit, janë transmetuar tek të diplomuarit apo sapodiplomuarit në Fakultetin e Shkencave Natyrore, duke shpejtuar kualifikimin e tyre dhe duke i përgatitur si specialistë të aftë për të punuar dhe drejtuar sektorë të rëndësishëm të Industrisë Ushqimore dhe njësi të procesit edukativ dhe shkencor në Universitet.

Gjatë gjithë jetës personale, profesionale e akademike, Profesori është shquar e nderuar me medalje e urdhëra. Ai është dekoruar me Medaljet e Kujtimit, të Çlirimit dhe Trimërisë dhe më pas është vlerësuar në karrierën profesionale

me Urdhërin e Punës, Urdhërin Naim Frashëri të Klasit të Parë e të Dytë si dhe me Titullin 'Punonjës i Shquar i Shkencës dhe i Teknikës'.

Megjithëse në pension, Profesori vazhdon të kontribuojë më të njëjtin pasion e përkushtim për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe shkencor në Degën e Kimisë Ushqimore. Ai vazhdon të mbetet njeriu i drejtë e korrekt, lektori i apasionuar, kërkuesi këmbëngulës e i papërtuar dhe miku më i mirë i të gjithë kolegëve e studentëve. Shumë punime shkencore të viteve të fundit pasqyrojnë këshillat dhe propozimet e tij; shumë studentë vazhdojnë të udhëhiqen nga Profesori i nderuar, në punimet e tyre teorike e eksperimentale. Institucionet kërkimore shkencore vlerësojnë punën e tij si ekspert dhe pasqyrojnë në tematikat e tyre mendimin e tij të mençur.

Profesor Muharrem Frashëri vazhdon të jetë pjesë e pandarë e stafit të degës Kimi Ushqimore dhe koleg i respektuar e i vyer i të gjithë punonjësve të Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Universitetit të Tiranës. Mendimi i tij është mendimi i urtë e i pjekur i Prindit dhe Profesorit.